



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201701526/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandim lidhur me problematikat e dala nga inspektimi i kryer në Shtëpinë e të Moshuarve, Shkodër.*

Drejtuar: **Zj. Luneda SUFALI**
Drejtoreshë e Përgjithshme
Shërbimit Social Shtetëror

TIRANË

Për dijeni: **Z. Edmond EMINI**
Drejtor i Shtëpisë së të Moshuarve

SHKODËR

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, më datë 17.11.2015, ka vijuar inspektimin në Shtëpinë e të Moshuarve, Shkodër.

Ky inspektim u krye në mbështetje të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe vecanerisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut".

"Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise".

Qëllimi i inspektimit ishte zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2015 si dhe vijimi i inspektimit.

Ju bëjmë më dije se më datë 03.11.2015, është kryer inspektimi në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër. Pas problemeve të konstatuara, i rekomanduam Shërbimit Social Shtetëror marrjen e masave për:

1. *Rikonstrukcionin e godinës.*
2. *Shtimin në organikë me kujdestarë, një psikolog, një kuzhinierë, shofer dhe gjetjen e mundësive për vendosjen e nje automjeti.*
3. *Emërimin sa më parë të punonjësit social.*
4. *Shtim në organikë me roje ose mbulimin e këtij shërbimi me roje private 24 orë.*
5. *Dërgimin e kopjeve të dokumentacionit të dosjeve të personelit të kësaj qendre.*
6. *Ngritjen e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme psikike në një qendër zhvillimi.*
7. *Për të rishikuar mundësinë e tenderimit të ilaçeve jo vetëm në fillim viti.*

Me shkresën nr.2635/3 datë 08.01.2016, lidhur me rekomandimet e sipërcituara, kemi marrë përgjigjet e mëposhtme:

- ***Për rekomandimin e parë***, SHSSH ka monitorur institucionin më datë 10.12.2015. Në atë kohë po kryhej rikonstrukcioni i pjesëshëm i godinës për përmirësimin e kushteve fizike të kësaj shtëpie. SHSSH la rekomandim për reduktimin e lagështirës, kryesisht në tualete. Në buxhetin e vitit 2016, SHSSH ka planifikuar rikonstrukcionin e godinës.
- ***Për rekomandimin e dytë***. Përfshirja e shoferit në strukturë është në kundërshtim të VKM nr.1139 datë 24.11.2009 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të Ministrive dhe institucioneve qendrore”. Gjatë vitit 2015, SHSSH rishikoi organikat e institucioneve të përkujdesit shoqëror dhe propozoi ndryshimet përkatëse në çdo institucion.
- ***Për rekomandimin e tretë***. Aktualisht në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër është emëruar punonjësi social.
- ***Për rekomandimin e katërt***. I është rekomanduar institucionit se 2 rojet që janë në organikë të alternojnë shërbimin e tyre duke mbuluar turnin e parë dhe të dytë. Për turnin e tretë i është rekomanduar institucionit të tenderojë shërbimin me roje private.
- ***Për rekomandimin e gjashtë***. SHSSH njih problematikën e përfirtuesve me probleme të shëndetit mendor, të cilët janë komisionuar në këtë qendër përpara vitit 2013. Përfirtuesit nuk mund të grupohen në qendër zhvillimi, pasi bira në kundërshtim me VKM nr.425 datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranimin e personave në institucionet publike dhe private të përkujdesjes sociale. Gjatë vitit 2016, SHSSH do të ngrejë grupin e punës, i cili do të vlerësojë përfirtuesit me probleme të shëndetit mendor me objektiv transferimin e tyre në një qendër socio-sanitare sipas standarteve të përkujdesit social.
- ***Për rekomandimin e shtatë***. Është kompetencë e vetë institucionit të krijojë mundësinë e prokurimit të medikamenteve dy herë në vit. Kjo problematikë është sqaruar me drejtuesin e institucionit.

Në takimin e bërë me drejtuesin e kësaj qendre dhe me punonjësen sociale, konstatuam se rekomandimi:

1. *Për rikonstrukcionin e godinës, është realizuar pjesërisht.*
2. *Për shtimin në organikë me kujdestarë, një psikolog, një kuzhinierë, shofer dhe gjetjen e mundësive për vendosjen e nje automjeti, nuk është realizuar.*
3. *Për emërimin sa më parë të punonjësit social, është realizuar.*
4. *Për shtim në organikë me roje ose mbulimin e këtij shërbimi me roje private 24 orë, është realizuar.*
5. *Për dërgimin e kopjeve të dokumentacionit të dosjeve të personelit të kësaj qendre, është realizuar.*
6. *Për ngritjen e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme psikike në një qendër zhvillimi, nuk është realizuar.*
7. *Për të rishikuar mundësinë e tenderimit të ilaçeve jo vetëm në fillim viti, nuk është realizuar. Kjo për arsye se duhen bërë ndryshime ligjore për prokurimet publike.*

Nga inspektimi i kryer rezultoi si më poshtë:

Në këtë Shtëpi të Moshuarish trajtohen 34 përfitues. 12 të moshuar janë transferuar nëpër Shtëpitë e tjera të të Moshuarve, pasi i gjithë institucioni është në rikonstrukcion. Kapaciteti është për 65 përfitues. Pjesa më e madhe e përfituesve vijnë nga pjesa veriore e vendit tonë, por ka edhe nga krahina të tjera. 8 persona janë nën moshë 60 vjeç, pasi janë strehuar prej vitesh në këtë institucion, që në moshën 18 vjeçare. 7 të moshuar janë me probleme të shëndetit mendor, prapambetje mendore, të cilët janë të ardhur nga Shtëpia e Fëmijës prej vitesh.

Personeli përbëhet nga 23 punonjës. Me problemet psiko-sociale merret punonjësi social dhe kujdestari. Shërbimi mjekësor realizohet nga një mjek me kohë të pjesshme. Plani individual shëndetësor për përfituesit pasqyrohet në kartelat e tyre personale. Shërbimi dentar kryhet në klinikat private, me shpenzimet e të moshuarve.

Kopjet e dosjeve të personelit mbaheshin në institucion, pasi dosjet origjinale ndodhen në Shërbimin Social Shtetëror. Përshkrimi i punës për personelin pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër. Vlerësimi i punës së tyre bëhet dy herë në vit dhe dërgohet në Shërbimin Social Shtetëror dhe një kopje mbahet në institucion. Stafi është trajnuar nga Shërbimi Social Shtetëror, por edhe nga vetë institucioni (punonjësja sociale). Është kryer një trajnim nga Kryqi i Kuq Shqiptar, duke u pajisur edhe me certifikatat përkatëse.

Lidhur me sistemin e ngrohjes-ftohjes, do të realizohet sipas projektit, me aspirim, sistem të mbrojtjes kundër zjarrit, sistem i pompave të ujit.

Kuota ushqimore ditore për çdo të moshuar është 300 lekë. Merret mendimi i përfituesve për përcaktimin e menisë së ushqimit. Menuja javore firmoset nga edhe nga një i moshuar. Ndërsa dieta ushqimore përcaktohet me rekomandim të mjekut, në prezencë dhe të një të moshuari.

Godina B ishte rikonstruktuar, me ambiente shumë të pastra. Në kuzhinë ishte vendosur soba industriale. Kampionet e ushqimit ruheshin në frigorifer. Ishte vendosur ashensori, i cili mirëmbahej çdo muaj.

Lidhur me zbatimin e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile ishte trajnuar stafi dhe mjetet ishin vendosur në kënde të veçanta.

Organizoheshin vazhdimisht aktivitete të ndryshme, ditëlindje, festat zyrtare, festat fetare, shëtitje, kafe në ambiente të ndryshme. Bëhej një plan aktivitetesh. Te moshuarit vizitohen nga të afërm dhe ka një regjistër, ku pasqyrohen takimet e bëra. Të afërmit informohen edhe nga stafi për problemet që mund të kenë të moshuarit.

Monitorimi i standarteve bëhet nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shociale, Instituti Higjenës, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Shërbimit Social Shtetëror, Shkodër, etj.

Gjatë bisedës me të moshuarit, ata u shprehën se ishin të kënaqur me shërbimin e stafit të këtij institucioni si dhe të drejtuesit të tij.

Gjatë këtij inspektimi, u konstatuan problematikat e mëposhtme:

Drejtori i institucionit nuk kishte dijeni për afatin e rikonstruksionit të godinave. Nuk disponon asnjë kontratë për këtë rikonstruksion, ndërkohë që punimet janë lënë në mes. Është kryer faza e parë e punimeve, i një pjese të Godinës B. Duhej të kishte filluar puna që në muajin Tetor 2017 për fazën e dytë të punimeve, në Godinën A.

Procedura e Prokurimit është kryer nga ish Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Që në muajin Nëntor 2016 është bërë shpërndarja e 12 të moshuarve në institucionet e tjera të përkujdesjes sociale për të moshuarit.

- Në organikën e punonjësve të qendrës nuk ka psikologë, tepër e rëndësishme për kategorinë e të moshuarve që e kanë të nevojshëm praninë e një psikologu gjatë tërë kohës.
- Kostoja financiare për roje private është më i lartë sesa shtimi në organikë me roje objekti. Për vetë specifikën e institucionit, roja duhet të jetë jo vetëm për ruajtjen e objektit, por edhe për mënyrën e komunikimit me të moshuarit, me vizitorët etj, sepse roja private ndryshon çdo vit kur kryhet prokurimi. **Do të sugjerim që ky shërbim të kalonte nga zëri 602 “Shpenzime operative” në zërin 600 dhe 601 “fond pagash dhe sigurime shoqërore.”**
- Kuota ditore ushqimore për çdo të moshuar në vlerën e 300 lekëve, sipas Drejtuesit të këtij institucioni, nuk është e mjaftueshme. Që në vitin 2011 nuk është bërë asnjë shtesë në këtë shërbim. Aktualisht, me rritjen e çmimeve të mallrave ushqimore, kërkohet rritje e vlerës së kuotës ditore, nga 300 lekë minimalisht në 350 lekë në muaj. Me shkresën nr. 87 datë 03.08.2016, në përgjigje të shkresës nr.1652 datë 20.07.2016 të Shërbimit Social Shtetëror për “Mendime në lidhje me kuotën ushqimore” për rezidentët në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, është arritur në konkluzionin se për plotësimin e nevojave jetike të përfituesve, është e nevojshme që mesatarisht kuota ushqimore ditor të jetë 370 lekë në muaj.
- Një problematikë që haset jo vetëm në këtë institucion, por në të gjitha qendrat e përkujdesjes sociale, është çështja e shërbimit dentar. Ky

shërbim mbulohet nga vetë të moshuarit. **Do të sugjerim që të një pjesë e këtij shërbimi të rimbursohet nga shteti.**

- Lidhur me donacionet që vijnë në këtë institucion, përta i përket artikujve ushqimor. Na u sqarua procedura e hyrjes në institucion dhe ky donacion përfshihet në kuotën ditore ushqimore të përfituesve, 300 lekë. Donacioni është zë në vete dhe nuk ka pse të përfshihet në kuotën ditore ushqimore . **Do të sugjerim krijimin e një komisioni të veçantë, brenda institucionit, ku pjesa më e madhe të jenë të moshuar, të cilët të monitorojë donacionet që vijnë, me qëllim shmangien e abuzimeve.**
- Në këtë institucion, siç u shprehëm më lart strehohen 7 të moshuar, të cilët janë me probleme të shëndetit mendor, gjë që bëhet pengesë për një jetesë normale të të moshuarve.
- Një problem shqetësues që ende ka mbetur pa i dhënë zgjidhje, është edhe ajo e mungesës së makinës dhe shoferit.

Sa më lart, për t'iu përgjigjur sa më shumë nevojave të personave përfitues në këtë qendër dhe për të plotësuar një nga standartet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale, siç është pasurimi i rretit te shërbimeve dhe rritja e cilësisë së tyre, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për:

- Fillimin e punimeve për fazën e dytë të projektit për rikonstruksionit të godineve.
- Shtimin në organikë me një psikolog, shofer dhe gjetjen e mundësive për vendosjen e nje automjeti.
- Shtim në organikë me roje objekti.
- Ngritjen e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme psikike në një qendër zhvillimi.
- Gjetjen e një zgjidhje për të monitoruar donacionet për produkte ushqimore, me qëllim që të mos përfshihen në kuotën ushqimore ditore.
- Rritjen e kuotës ushqimore ditore, minimalisht në 350 lekë.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se,

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI